

GJYKATA E QARKUT NË PEJË/PEC

P.nr.280/09

Data 6 Gusht 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT E PEJËS/PEC, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi Ndërkombëtar Gianfranco Gallo si Gjykatës Kryesues, Gjykatësi Ndërkombëtar Gerrit-Marc Springer dhe Gjykatësi Kosovar Muharrem Hoti si anëtarë të trupit, të ndihmuar nga Procesmbajtësi Robert Abercrombie, në rastin penal kundër të akuzuarit:

NIKOLLË GOJANI, lindur me 01 dhjetor 1974 në Novosellë e Ulët, komuna e Gjakovës/ Ëakovica, mashkull, emri i babës Tush Gojani, emri vajzëror i nënës Vitore Lleshaj, Shqiptar Kosovar, me banim në Novosellë e Ulët, komuna e Gjakovës/ Ëakovica, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me shkollë fillore të kryer, kinse i padënuar më parë, në paraburgim nga data 17 Nëntor 2008, aktualisht i paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Pejë,

GJOK JAKAJ, lindur me 8 janar 1982 në Gjakovë/Ëakovica, mashkull, emri i babës Zef Jakaj, emri vajzëror i nënës Zoje Dedaj, Shqiptar Kosovar, me banim në Novosellë e Ulët, komuna e Gjakovës/Ëakovica, i martuar ka dy fëmijë, me shkollë fillore të kryer, i gjendjes së varfër ekonomike, profesioni-voztës i buldozerit, kinse i padënuar më heret, në paraburgim nga 17 nëntori 2008, aktualisht në Qendrën e Paraburgimit në Pejë.

GJIN GJOKAJ, lindur me 3 qershor 1979 në fshatin Trakaniq, komuna e Gjakovës/ Ëakovica, mashkull, emri i babës Nue Gjokaj, emri vajzëror i nënës Age Lasku, Shqiptar Kosovar, me banim në fshatin Trakaniq, komuna e Gjakovës/ Ëakovica, i pamartuar, bujk, me shkollë fillore, gjendja ekonomike mesatare, kinse i padënuar më parë, në paraburgim nga 18 nëntori 2008, aktualisht i paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit të Pejës.

Të akuzuar, sipas aktakuzës PPQ 165/08 të datës 1 qershor 2009, dhe të parashtruar në Gjykatë me 9 qershor, për veprën penale në vijim:

1. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim të Nenit 229 paragrafi 4 në lidhje me Nenin 23 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës ("KPK")

Sepse:

Nga gjysma e Shtatorit 2008 deri në 18 Nëntor 2008, qëllimisht dhe në bashkë-kryerje, të pandehurit kanë siguruar substanca narkotikë të lojtit marihuana, në total

Prej 152,5 kg të paketuar në 305 qese të plastikës në fshtain Novosellë e Ulët dhe Trakaniq, të komunës së Gjakovës/ Đakovic.

Të pandehurit mbajtën në posedimin e tyre këtë sasi të substancës narkotike në shtëpinë e Nikollë Gojani-t në fshatin Novosellë e Ulët dhe mëpastaj në shtëpinë e Gjin Gjokaj-t në fshatin Trakaniq me qëllim që t'ia shesin atë palëve të treta për të siguruar përfitim të paligjshëm.

Dhe,

2. Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve në kundërshtim me Nenin 328 par.2 i KPK

Sepse

I pandehuri Gjokë Jakaj, për një periudhë të paverifikuar të kohës deri me 18 Nëntor 2008, posedoi armët në vijim dhe municionin pa autorizim valid nga institucioni kompetent: një pushkë automatike "Shmajzer" me numër serial 168203, dy karikatorë për këtë pushkë, një armë gjuetie me numër serial YU23208, pesë plumba të kalibrit 7.62x25mm dhe një karikator për revole TT.

Dhe

I pandehuri Gjin Gjokaj për një periudhë të paverifikuar të kohës deri em 18 nëntor 2008 posedoi armët në vijim dhe municionin pa autorizim valid nga institucioni kompetent: një pushkë automatike Thompson me numër serial SO7571 dhe dy granata dore me simbolin A-6Y.

Pas mbajtjes së ndëgjimeve të shqyrtimit kryesor në mënyrë publike me 28 korrik 2009, 29 korrik 2009, 4 gusht 2009 dhe 6 Gusht 2009 në prani të:

-Të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre, përkatësisht Z.Armend Krasniqit për Nikollë Gojanin, Znj. Sanije Seferi për Gjokë Jakaj dhe Znj.Nushe Kuka-Mekaj për Gjin Gjokaj.

- Prokurorit Publik Special Z. Lulzim Sylejmani-t:

Pas diskutimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur me 6 Gusht 2009, bazuar në Nenin 391 Paragrafi 91) i KPPK,

Me 6 gusht 2009, në përputhje me Nenin 392 Pargrafi (1) i KPPK, shpall publikisht dhe në prani të të akuzuarve, Prokurorit Special në mungesë, aktgjykimin në vijim:

NIKOLLË GOJANI

Është

GJETUR FAJTOR

Për kryerjen e veprës penal të posedimit dhe sigurimit të substancave narkotike të llojit të marijuanës në peshë totale prej 152,5 kg. të paketuara në 305 qese të plastikës, së pari në shtëpinë e Nikollë Gojanit në fshatin Novosellë e Ulët e mëpstaj në shtëpinë e Gjin Gjokajt në fshatin Trakaniq me qëllim të shitjes apo shpërndarjes së saj, në Novosellë të Ulët deri me 18 nëntor 2008,

ANDAJ, i akuzuari

DËNOHET

*Me dy (2) vjet burgim dhe me gjobë prej 2.500 Euro për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim të Nenit 229, par.1 i KPK.
Sipas Neneve 54,60 dhe 229 par.5 i KPK narkotikët e kapur në shtëpinë e Gjin Gjokajt me 18.11.2009 dhe në veturën "Citroen" me targa 512 KS 951, do të konfiskohen.*

GJOKË JAKAJ

LIROHET NGA AKUZA

Për kryerjen e veprës penal të posedimit dhe sigurimit të substancave narkotike të llojit të marijuanës në peshë totale prej 152,5 kg. të paketuara në 305 qese të plastikës, së pari në shtëpinë e Nikollë Gojanit në fshatin Novosellë e Ulët e mëpstaj në shtëpinë e Gjin Gjokajt në fshatin Trakaniq me qëllim të shitjes apo shpërndarjes së saj, në Novosellë të Ulët deri me 18 nëntor 2008, sepse nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprën për të cilën ishte akuzuar.

GJOKË JAKAJ

Është

GJETUR FAJTOR

Për kryerjen e veprës penale të posedimit deri me 17.11.2008 në shtëpinë e tij në fshatin Janosh, komuna e Gjakovës armët në vijim dhe municionin pa leje valide nga institucioni kompetent; një pushkë automatike Shmajzer me numër serial 168203, dy karikatorë për

këtë pushkë, një armë gjuetie me numër serial YU23208, pesë plumba të kalibrit 7,62x25mm dhe një karikator të revolës TT.

ANDAJ, i akuzuari

DËNOHET

*Me një (1) vjet burgim për veprën penale Mbjajta në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve në kundërshtim me Nenin 328 par.2 i KPK
Sipas Neneve 41,42,43, dhe 44 të KPK dënimi është pezulluar dhe andaj dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale për një periudhë prej 5 vjetëve.
Sipas Neneve 54,60,229 par.5 i KPK armët e kapura në shtëpinë e Gjokë Jakajt do të konfiskohen.*

GJIN GJOKAJ

Është

GJETUR FAJTOR

Për kryerjen e veprës penal të posedimit dhe sigurimit të substancave narkotike të llojit të marihuanës në peshë totale prej 152,5 kg. të paketuar në 305 qese të plastikës, së pari në shtëpinë e Nikollë Gojanit në fshatin Novosellë e Ulët e mëpastaj në shtëpinë e Gjin Gjokajt në fshatin Trakaniq me qëllim të shitjes apo shpërndarjës së saj, në Novosellë të Ulët deri me 18 nëntor 2008,

Është

GJETUR FAJTOR

Për kryerjen e veprës penale të posedimit deri me 17.11.2008 në shtëpinë e tij në fshatin Trakaniq, komuna e Gjakovës armët në vijim dhe municionin pa leje valide nga institucioni kompetent: një pushkë automatike Thompson me numër serial SO7571 dhe dy granata dore me simbolin A-6Y.

ANDAJ, i akuzuari

DËNOHET

Me një (1) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim dhe me gjobë prej 2.000Euro për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim të Nenit 229, par.1 i KPK.

Me një (1) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve në kundërshtim me Nenin 328 par.2 i KPK

Dënimi unik, në përputhje me Nenin 71 paragrafi (1) dhe (2) nën-paragrafi 2, i KPK është përcaktuar në dy (2) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim dhe një gjobë prej 2.000Euro.

Sipas Neneve 54,60,229 par.5 dhe 328 par.5 i KPK narkotikët dhe armët e kapura në shtëpinë e Gjin Gjokajt dhe narkotikët e gjetur në veturn, marka "Citroen", me targa 512 KS 951, do të konfiskohen.

Telefonat mobil të konfiskuar gjatë hetimit dhe që i takojnë Skender Lejkajt, Gjoke Jakajt, Nikollë Gojanit, Gjin Gojanit do t'i kthehen pronarëve legjitim.

Koha e kaluar në paraburgim nga të pandehurit do të llogaritet në dënimin e shqiptuar, në përputhje me Nenin 391 Paragrafi(1) nën-paragrafi 5 i KPPK.

Të akuzuarit do t'i kompenzojnë shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 102 paragrafi(1) i KPPK me përjashtim të shpenzimeve të interpretimit dhe përkthimit. Një vendim i veçantë mbi vlerën e shpenzimeve do të sillet nga gjykata kur të dhënat e tilla të jenë siguruar në përputhje me Nenin 100 paragrafi(2) i KPPK.

* * *

ARSYETIMI

SFONDI PROCEDURAL - AKTAKUZA

Me 9 qershor 2009, Prokurori Publik Special parashtroi aktakuzën PPQ. Nr. 165/2008 në Gjykatën e Qarkut të Pejës/Peć, kundër të pandehurve Nikollë Gojani, Gjokë Jakaj, Gjin Gjokaj dhe Mic Kukelaj, duke e akuzuar Nikollë Gojanin, Gjoke Jakajn dhe Gjin Gjokajn për kryerjen e veprës penale . *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike* në kundërshtim të Nenit 229 paragrafi 4 në lidhje me Nenin 23 paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës("KPK") dhe Gjoke Jakaj, Gjin Gjokaj dhe Mic Kukelaj për kryerjen e veprës penale *Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve* në kundërshtim me Nenin 328 par.2 i KPK. Sipas aktakuzës, nga mesi i Shtatorit deri me 18 Nëntor 2008, të pandehurit Nikollë Gojani, Gjoke Jakaj dhe Gjin Gjokaj mbajtën në posedim 152,5kg marihuanë të paketuar në 305 qese të plastikes, së pari në shtëpinë e Nikollë Gojanit në fshatin

Novosellë e Ulët dhe mëpastaj në shtëpinë e Gjin Gjokajt në fshatin Trakaniq, me qëllim që t'ia shesin atë palëve të treta dhe që të sigurojnë përfitim të paligjshëm.

Për më tutje, i akuzuari Gjoko Jakaj ishte akuzuar për posedim, deri me 17 nëntor 2008, në shtëpinë e tij në fshatin Janosh, komuna e Gjakovës, të armëve dhe municionit në vijim pa leje valide nga institucioni kompetent: një pushkë automatike Shmajzer me numër serial 168203, dy karikatorë për këtë pushkë, një armë gjuetie me numër serial YU23208, pesë fishekë të kalibrit 7,62x25 mm dhe një karikator për revole TT.

I akuzuari Gjin Gjokaj ishte akuzuar për posedim deri me 17 nëntor 2008, në shtëpinë e tij në fshatin Trakaniq, komuna e Gjakovës të armëve dhe municionit në vijim pa pasur leje valide nga institucioni kompetent: një pushkë automatike Thompson me numër serial SO7571 dhe dy granata dore me simbol A-6Y.

Përfundimisht, i akuzuari Mic Kukelaj ishte akuzuar për posedimin deri me 17 nëntor 2008, në shtëpinë e tij në Gjakovë të armëve dhe municionit në vijim pa pasur leje valide nga institucioni përkatës: një revole TT me numër serial H-93618 të kalibrit 7,62 mm, dy karikatorë për këtë revole dhe tetë fishekë të kalibrit 7,62mm.

Me këto veprime, sipas aktakuzës, të pandehurit Nikollë Gojani, Gjokë Jakaj dhe Gjin Gjokaj kanë kryer, në bashkë-kryerje, veprën penale të *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim të Nenit 229 paragrafi 4 në lidhje me Nenin 23 paragrafi 1 i KPK-së* e dënueshme me burgim nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet. Për më tutje, sipas aktakuzës, të pandehurit Gjokë Jakaj, Gjin Gjokaj dhe Mic Kukelaj kanë kryer veprën penale të *Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve* në kundërshtim me Nenin 328 par.2 i KPK, e dënueshme me gjobë deri në 7500 Euro apo me burgim nga një deri në tetë vjet.

Ndëgjimi për konfirmimin e aktakuzës ishte mbajtur me 2 korrik 2009 në Gjykatën e Qarkut të Pejës/Peć, në prani të të pandehurve, përveq Mic Kukelajt, mbrojtësve të tyre dhe prokurorit special. I pandehuri Mic Kukelaj parashtroi me 29 qershor 2009 një dokument me shkrim mbi heqjen dorë nga shqyrtimi i aktakuzës.

Aktakuza pjesërisht ishte konfirmuar përmes aktvendimit KAQ.nr.173/09, të datës 3 korrik 2009: në fakt Gjykatësi Konfirmues nuk e konfirmoi se akuza sipas Nenit 229 të KPK ishte në lidhje me Nenin 23 të KPK (kështu që akuza e konfirmuar ishte vetëm sipas Nenit 229 par.1 dhe 4), pasi që "kualifikimi i krimit pasi që është kryer nga anëtari i grupit e absorbon bashkëfajësinë dhe në të njëjtën kohë e parandalon akuzën e veçantë të bashkëfajësisë". Kurrfarë ankesë nuk ishte bërë kundër aktvendimit të përmendur më lartë.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

1. Procedura, Kompetenca dhe Përbërja e Gjykatës së Qarkut të Pejës/Peć

Sipas Nenit 23 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këtu e tutje KPPK), Gjykatat e Qarkut kanë jurisdiksionin të gjykojnë në shkallën e parë veprat penale të dënueshme me burgim prej së paku pesë vjet apo me burgim afatgjatë.

Veprat e paraqitura në aktakuzë janë të dënueshme me gjobë dhe me burgim nga tre deri në pesëmbëdhjet vjet sa i përket veprës penale të *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike* dhe me gjobë deri në 7500Euro apo me burgim nga një deri në tetë vjet përkitazi me veprën penale *Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve*.

Veprat penale , sipas aktakuzës , ishin kryer në fshatin Novosellë e Ulët dhe në fshatin Traqanik, Komuna e Gjakovës, që gjenden brenda territorit të Qarkut të Pejës/Peç. Andaj, sipas Nenit 27, par.1 i KPPK, Qarku i Pejës/Peç e ka jurisdiksionin territorial për të gjykuar rastin aktual.

Në përputhje me Nenin 3 të Ligjit mbi Jurisdiksionin, Përzgjedhjen e Rasteve dhe Caktimin e Rasteve Gjykatësve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në procedurë penale do të kenë jurisdiksionin dhe kompetencën mbi çfarëdo rasti të hetuar apo të ndjekur nga Prokurorët Special të Republikës së Kosovës.

Rasti aktual ishte hetuar dhe aktakuza ishte bërë nga Prokurori Special i Kosovës dhe , andaj , sipas Nenit 4.7 të LoJ, trupi gjykues i Gjykatës së Qarkut të Pejës/Peç ishte kompozuar nga një panel i përzier i dy Gjykatësve të EULEX-it dhe një Gjykatësi Vendor.

Kështu që, mund të përfundohet se Gjykata e Qarkut e Pejës /Peç e ka jurisdiksionit e rastit-lëndës për të gjykuar rastin aktual.

Asnjë nga palët nuk ka vërejtje për përbërjen e trupit gjykues.

2. Seanca kryesore

Shqyrtimi kryesor ishte mbajtur publikisht me 28 dhe 29 korrik 2009,4 dhe 6 gusht 2009, në prani të të akuzuarve Nikollë Gojani, Gjokë Jakaj dhe Gjin Gjokaj dhe mbrojtësve të tyre, përkatësisht, Armand Krasniqit, Sanije Seferit dhe Nushe Kuka-Mekajt, dhe Prokurorit Publik Special, Lulzim Sylejmani.

I pandehuri Mic Kukelaj nuk morri ftesë për shqyrtim kryesor dhe nuk erdhi në ndëgjimin e parë. Andaj, në përputhje me Nenin 34 të KPPK, procedura kundër Mic Kukelaj ishte ndarë dhe gjykimi vazhdoi kundër të tre të pandehurve tjerë.

Në përputhje me Nenin 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtar përkthyen procedurën gjyqësore dhe të gjitha dokumentet relevante në gjuhën Shqipe në Angleze, siç nevojitej.

C. PËRMBLEDHJA E PROVAVE TË PARAQITURA

1. Dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspert

Gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor, dëshmitarët dhe dëshmitarët ekspert në vijim ishin marrur në pyetje:

- V. G., me 28 korrik 2009
- S. L., me 29 korrik 2009
- Z. A. N., me 29 korrik 2009

V. G. ishte prezantuar nga mbrojtësi i Nikollë Gojanit. Ai dëshmoi se, një ditë, gjatë vjeshtës 2008, në mes të orës 10 apo 11 në mëngjes, ai e pa Nikollë Gojanin me tre persona në rrugë. Kur ai hyri në oborr të shtëpisë së tij, ai ndëgjoi bërtitje dhe zhurma dhe kur doli në rrugë, ai e pa Nikollë Gojanin të shtrirë në tokë përpara shtëpisë së tij. Kur ai e pyeti Nikollë Gojanin se çfarë kishte ndodhur, ai u përgjegg se disa shokë të tij e goditën atë dhe mëpastaj ikën. Ai e vërejti se Nikolla Gojani ishte lënduar lehtë në fytyrë. Ai poashtu vërejti se tre personat ikën nga aty me një veturë Golf, të tipit 3 apo 4. Ai vetëm e pyeti Nikollë Gojanin se kush ishin ata persona dhe nuk e pyeti pse e kishin goditur atë.

S. L. ishte prezantuar nga Prokurori Special. Kërkesa ishte bërë gjatë seancës së 28 korrikut dhe ishte aprovuar nga trupi gjykues. Atij iu bënë pyetje për veturën e tij dhe ai tha se kishte blerë veturën e tij, një Citroen pick-up, dy vjet e gjysmë më përpara dhe se e kishte përdorur atë kryesisht për punën e tij ditore si auto-mekanik. Dëshmitari shpjegoi se ai i huazonte veturën e tij njerëzve të ndryshëm pasi që ata e kërkonin atë dhe ai i huazoi veturën të pandehurit Gjok Jakaj sa herë që këtij të fundit i nevojitej vetura. Përkitazi me rastine fundit kur Gjok Jakaj kërkoi të huazoj veturën nga Skender Lekaj, dëshmitari shpjegoi se Gjoka e kërkoi veturën për arsye familjare dhe, në veqanti, se Gjokës i nevojitej vetura që të shkoj me motrën e tij për të marrë një dokument zyrtar. Motra e tij duheshte të voziste pasi që Gjokë Jakaj nuk posedonte lejen e vozitjes. I pyetur nga kryetari i trupi gjykues dëshmitari theksoi se Gjokë Jakaj e kërkoi veturën me 16 nëntor, derisa ky ishte duke hyrë në një shitore ushqimore. Dëshmitari ia dha atij qelësat e veturës. Dëshmitari shpjegoi se kishte zakon të huazonte veturën Gjok Jakajt kur atij i duhej dhe se ai e dinte që Gjokë Jakaj nuk kishte leje për vozitje, por se njëri nga anëtarët e familjes do ta voziste veturën. Pas kërkesës, dëshmitari u përgjegg se ai nuk ishte i sigurt nëse i dha qelësat Gjokë Jakajt apo se ata ishin brenda në veturë. Ai hyri në shitore dhe nuk e pa Gjokë Jakajn duke shkuar me veturë. Ai shpjegoi se, pasi që Gjokë Jakaj e morri veturën, ai nuk e di se çfarë ndodhi me automjetin.

Z. A. N. (e cila punon si analiste për Laboratorin Qëndror Kriminal të Policisë së Kosovës, seksioni për narkotikë dhe për kimi, në Prishtinë) kreu, me 30 Janar 2009, një ekspertizë të substancës të gjetur në shtëpinë e Gjokajt. Prokurori kërkoi me 28 korrik 2009 që Znj. Nimanaj të merret në pyetje si dëshmitare eksperte dhe trupi gjykues e aprovoi kërkesën (dëshmitarja eksperte e dha deklaratën e vet me 29 korrik 2009).

~~...~~ A. N. deklaroi se ajo pranoi një provë nga polici Maliq Konushefci dhe se ajo provë përbëhej nga një qese e letrës për prova e izoluar, që përmbante 305 qese të plastikës me substanca bimore brenda, të ngjyrës së gjelbërt. Të gjitha qeset peshonin pak a shumë ngjajshëm. Me qëllim që të kryhet analiza, ajo mori mostrat nga 40 qese prej 305 sosh. Konkluzioni i raportit të saj ishte se në të gjitha 40 mostrat ishte e pranishme *cannabis-i* (marihuana që përmbante tetrahydrocannabinol (THC)).

~~...~~ A. N. u paraqit në gjykatë dhe ishte kërkuar që të sqaroj pse raporti i saj fliste për 1352 gram ndërsa sasia totale e narkotikëve të konfiskuar ishte 152 kilogram. Dëshmitarja eksperte shpjegoi se ajo pranoi nga policia vetëm 305 qese me total peshë 1352 gram. Dëshmitarja eksperte nuk ishte në dijeni se kush zgjodhi 305 gramët nga sasia totale e narkotikëve të konfiskuar dhe se ku ishte pjesa e mbetur e narkotikëve. Ajo bëri analiza vetëm në mostrat që ishin dërguar në laborator. Ajo poashtu shpjegoi se, si rregullë në departamentin e saj, kur mostrat paraqiten të jenë të njejta, analizat do t'i përkasin vetëm 10%-shit të totalit (kjo është arsyeja pse ajo i ekstraktoi dhe analizoi vetëm 40 mostra). Kur u pyet për fuqinë e narkotikëve, dëshmitarja eksperte shpjegoi se departamenti i saj nuk ka kryer analizë mbi fuqinë e narkotikëve për shkak të mungesës së rregullave të brendshme procedurale.

Ajo theksoi se bima *cannabis* përmbante 62 cannabinoide, dhe THC ishte substancë psiko-aktive dhe ishte element që e bënte *cannabis-in* një substancë të ndaluar. Sidoqoftë, ajo nuk kreu analizë mbi sasinë e THC që gjendej në këto mostra. Ajo theksoi se laboratori ku ajo punonte ishte laboratori i vetëm në Kosovë që kryen analiza të tilla dhe se rregulla ishte që të kryhen analiza kualitative e jo kuantitative.

2. Deklaratat, raportet policore dhe provat e tjera dokumentare të marrura parasysht gjatë seancave të gjykimit.

a) Provat dokumentare dhe raportet

Gjatë shqyrtimit kryesor raporti dhe dokumentet në vijim ishin marrë parasysht si të lexuara me koncensus nga të gjitha palët:

- Raporti i kontrollit të shtëpisë së të pandehurit Gjin Gjokaj me 18 nëntor 2008 me dy dokumente konfirmuese mbi konfiskimin e narkotikëve, marihuanës dhe armëve;
- Foto-dokumentacioni i vendit i datës 18 nëntor 2008;
- Raportet e kontrollit të shtëpisë së të pandehurit Gjoke Jakaj me 17 nëntor 2008 me dy dokumente konfirmuese mbi konfiskimin e narkotikëve, marihuanës dhe armëve;
- Regjistri i thirrjeve të pranuar dhe të bëra nga numrat e telefonave të Nikollë Gojanit, Gjin Gjokajt, dhe Gjokë Jakajt, poashtu edhe mesazhet me tekst të dërguara dhe të pranuar në numrat telefonik në vijim: 044 188 557, 044 466 606, 044 246 075, 044 230 496, 044 306 030 dhe 044 266 131.
- Raporti policor i datës 20 nëntor 2008
- Raporti policor i datës 18 nëntor 2008 i nënshkruar nga polici Fatmir Tahir Begolli.
- Raporti policor i datës 18 nëntor 2008, i nënshkruar nga polici Haki Lakaj.

- Deklarata e dhënë nga Nikollë Gojani Prokurorit me 1 dhjetor 2008 dhe Prokurorit të EULEX-it me 11 mars 2009, e pranuar dhe e marrë si e lexuar në prova në seancën e gjyqimit të 29 korrikut 2009.
- Ekspertiza e kryer në narkotikët e gjetur me 30 Janar 2009, që mban numrin Regjistruar 2008-2413.

b) Deklaratat e të akuzuarit

Nikolle Gojani fillimisht zgjodhi të përgjigjet në disa pyetje e pastaj të mbetet i heshtur në lidhje me disa të tjera, por pas disa pyetjeve ai vendosi vetëm që të qëndroj pranë deklaratës që i kishte dhënë Prokurorit të EULEX-it Francesco Mandoi me 11 mars 2009 dhe mos të përgjigjet në pyetjet e tjera. Kjo deklaratë i ishte ofruar trupit gjykues nga Prokurori.

Marrja në pyetje orale: I Pandehuri deklaroi se, mu në fillim, se ai nuk e diti se materiali për të cilin ishte kërkuar që t'a mbante ishte narkotikë: ai mendoi se ishte bari i thjeshtë. Ai e kuptoi se ishte narkotikë disa ditë më vonë, kur shoku i tij nuk erdhi të merr materialin, pasi që ai fillimisht tha se do t'a lente atë për një apo dy ditë. Ai i pranoi narkotikët për afërsisht një muaj e gjysmë para se të arrestohej. Kur u pyet nga Gjykatësi Kryesues, Nikollë Gojani konfirmoi se njerëzit të cilët ia dhanë narkotikët dhe njerëzit që e rrahën në rrugë ishin personat e njejtë. I Pandehuri shtoi se Gjin Gjokaj dhe Gjok Jakaj nuk patën të bëjnë asgjë me këtë çështje.

Deklarata e dhënë Prokurorit me 1 dhjetor 2008:

Nikollë u takua me një person të quajtur D. përmes një shoku të tij të quajtur M.B. dhe u bë shok me D. Në tetor 2008 D. e thirri Nikollen me qëllim që të takohen në Novosellë të Ulët dhe kërkoi nga Nikolla që t'a lejonte t'i le disa gjëra në shtëpinë e Nikollës.

Nikolla e pranoi këtë, dhe të nesërmen, D. u kthye me një furgon dhe dy persona të tjerë dhe ata i shkarkuan disa thasë të zi të cilët u futën në shtëpinë e Nikollës. Doja tha se ai do të kthehej ditën e nesërme apo një ditë më pas për t'i marrë ato gjëra.

Disa ditë më vonë, Nikolla e thirri D. që të vinte por ai asnjëherë nuk erdhi.

Pas dy javëve, një takim ndodhi në Gjakovë dhe D. erdhi me një person nga Shqipëria: Nikolla tha se D. do të duhej të vinte të marrë substancën, përndryshe ai do t'i raportonte policisë por personi nga Shqipëria iu kërcënua Nikollës duke i thenë se njerëzit mund të lëndohen për këtë lloj veprimesh.

Një takim i mëtutjeshëm ndodhi në fshatin Novosellë ku D. ishte i pranishëm me dy persona tjerë: Kur Nikolla i tha D. përsëri se ai do të raportonte në polici, njëri nga personat e kërcënoi se do t'a digjte atë dhe familjen e tij dhe përfundimisht këta persona e goditën atë në kokë me një gjësend. Ai e humbi vetëdijën dhe djali i xhaxhait të tij V.G. erdhi dhe e pyeti se çfarë kishte ndodhur.

Mëpastaj Nikolla e thirri D. që t'a pyes përse ishte kërcënuar ashtu dhe se ai do të shkonte në polici, por D. tha se personi Shqiptar e paralajmëroi atë se ai dhe familje e

tij do të "hiqeshin". Nikolla shpjegoi se ai kishte mbetur në dilemë të raportonte në polici apo të jetë cak i hakmarrjes.

Me 16 nëntor, përsona të panjohur e ftuan atë të takohej. D ishte i pranishëm poashtu dhe Nikolla përsëri kërkoi nga ata t'i largojnë gjërat nga shtëpia e tij.

Pasi që asgjë nuk ndodhi, ditën e njejtë ai kërkoi nga Gjini Gjokaj t'i ndihmoj atij dhe të magazinonjë drogën në shtëpinë e Gjinit. Me qëllim që të kryejnë transferin, ai e huazoi veturën e S. L. që ishte e parkuar në oborrin e Gjokë Jakajt. Ai e pyeti nënën e Gjokë Jakajt për leje. Ai i shpjegoi situatën e tij Gjini Gjokajt i cili, me të kuptuar se Nikolla ishte shumë nervoz, pranoi t'i ndihmoj atij dhe t'i mbaj artikujt për disa ditë. Nikolla i barti thasët personalisht brenda shtëpisë së Gjinit dhe i futi ato në një dhomë në katin e dytë.

Mëpastaj Gjini i dha atij qelësat e dhomës pasi që ai nuk donte të jetë i përfshier.

Nikollë mëpastaj e ktheu veturën prapa dhe me veturën e tij personale shkoi në Gjakovë ku u takua me Gjoke Jakajn dhe Mic Kukelajn. Mëpastaj, rreth orës 17.00hrs, ata të gjithë ishin arrestuar.

Nikolla shtoi se ai kurrë nuk i kishte hapur thasët, shitur apo përdorur çfarëdo sasive të narkotikëve nga thasët.

Deklarata dhënë Prokurorit të EULEX-it me 11 mars 2009: Nikollë Gojani tha se e gjitha filloi kur ai e takoi dikënd të quajtur D, përmes një shoku nga Gjilani të quajtur

M.B. Nikolla u bë shok me D, dhe ata hanin darka së bashku në Gjilan dhe në kafeteritë e Gjakovës. Në gusht 2008 D e thirri atë dhe kërkoi takim se kishte një punë për Nikollën. Kur u takuan, D i tha Nikollës se atij i duhej një favor dhe kërkoi që Nikolla të mban disa gjëra në shtëpinë e tij, sepse ai nuk mund t'i merrte ato në Gjilan; Kur Nikolla pyeti se çfarë kishte në thasë, D tha se ishte një lloj medikamenti. Nikolla theksoi se nuk donte asgjë të paligjshme në shtëpinë e tij dhe D tha se do t'i lente thasët aty vetëm për një apo dy ditë. Pastaj, dikush me emrin A erdhi me një person tjetër më një furgon dhe i solli gjërat tek shtëpia e Nikolla Gojanit.

Nikollë Gojani shpjegoi se ai kuptoi nga D se gjërat i takonin D dhe se ato i bleu nga dikush në Shqipëri. Nikolla theksoi se emri i vërtetë i D ishte D.

Kur, pas një jave, D nuk erdhi të marrë thasët, Nikolla shkoi në Gjilan që t'a kërkoj atë, por nuk mundi t'a gjej. Më vonë, kur ata u takuan në një restaurant, Nikolla i tha D që t'i merr gjërat apo ndryshe ai do t'i hudhte ato. Një person tjetër i quajtur N nga Vlora e Shqipërisë ishte aty dhe i tha Nikollës se gjërat i përkisnin atij dhe se Nikolla do të kishte probleme serioze nëse do t'i hudhte ato apo të thërras policinë. Përsoni nga Shqipëria iu kërcënua atij duke i thënë se njerëzit vriten për gjëra të tilla në Shqipëri. Mëpastaj, D erdhi të shoh Nikollën së bashku me atë personin nga Shqipëria dhe ky person e goditi Nikollën me pjesën e prapme të revolës së tij dhe kur Nikolla e thirri D për t'u ankuar, ky i fundit i tha Nikollës se ai do të merrte 3000 Euro në këmbim të mbajtjes së gjëravë në shtëpi. Ai kurrë nuk i morri paratë. Nikolla Gojani poashtu përmendi se ai e vërejti se disa përsona po e përcjellnin atë.

Për më tutje Nikollë Gojani shpjegoi se ai huazoi veturën e Skender Lekajt nga oborri i Gjokë Jakajt për shkak se ajo ishte më e përshtatshme që të bartë drogën nga shtëpia e tij. Ai e pyeti nënën e Gjokë Jakajt për veturën dhe poashtu kishte kërkuar lejen nga Skender Lekaj për veturën. Ai më herët kishte pyetur Gjini Gjokajn nëse do të mund të magazinonte artikujt në shtëpinë e Gjinit dhe i shpjegoi atij se ai kishte telashe me *mafian*.

Perfundimisht Nikollë Gojani përfundoi deklaratën e tij duke thënë se Gjini Gjokaj dhe Gjokë Jakaj nuk kishin asgjë të bënin me drogën.

Deklaratat e mësipërme të dhëna nga i pandehuri gjatë hetimit ishin konsideruar si të lexuara me zë me koncensus të të gjitha palëve.

Gjini Gjokaj ishte marrur në pyetje në shqyrtimin kryesor me 4 Gusht 2009.

Ai shpjegoi se, me 17 nëntor, Nikollë Gojani e kontaktoi atë përmes telefonit me qëllim që të takoheshin. Kur Gjini Gjokaj hyri në veturën e Nikolla Gojanit (një Fiat), ai vërejti se Nikolla ishte në "gjendje paniku". Nikollë i shpjegoi se ishte në rrezik nga mafia dhe se i duhej ndihma e Gjinit në mënyrë që të magazinohen disa artikujt në shtëpinë e tij.

Pesëmbëdhjetë minuta më vonë, në mes të orës 15.00 dhe 16.00, Nikollë Gojani i solli artikujt në shtëpi të cilët ishin në forme të thasëve të zi të plotë të përfaqësuesit lartësisë 1 meter e 20 centimetra. Nikollë erdhi tek shtëpia e Gjinit që të sjell drogën me një Citroen Pick up. Gjini Gjokaj e njohu veturën që ishte e Skender Lekajt.

Gjini Gjokaj deklaroi se e pyeti Nikollë Gojanin se çfarë kishte brenda në thasë dhe Nikollë Gojani u përgjigj: "Marihuanë". Gjini Gjokaj i tha trupit gjykues se ai nuk e dinte domethënien e asaj fjale, pasi që ai ishte një fshatar i thjeshtë dhe se ai mendonte se ajo ishte bari nga fusha, Gjykatësi Hoti e pyeti atë nëse ai ndonjëherë më parë kishte sjellur sjellur bari nga fusha në shtëpinë e tij. Gjini u përgjigj se kurrë nuk e kishte bërë atë. Gjini tha se, kur ai ishte arrestuar, ai i tha policisë se ai nuk dinte saktësisht se çfarë kishte brenda në thasë dhe tha se ai mendoi se ishte sanë apo bari i fushës apo një medikament.

Gjini shpjegoi se Nikolla ishte i vetmi që i barti thasët në shtëpi: në një pikë ai u bellafaua me deklaratën e tij të mëhershme, dhënë policisë me 19 nëntor 2008, ku Gjini deklaroi si në vijim "Nikollë Gojani erdhi në shtëpinë time 10 minuta më vonë me veturën pick up, një Citroen i verdhë, dhe e parkoi atë në oborrin tim. Mëpastaj *ne* i sollëm thasët në dhomë". Pasi u pyet që të skjaroj, i vetmi shpjegim i dhënë nga i pandehuri ishte se ai kurrë nuk i kishte thënë policisë fjalët e lartëpërmendura.

Gjini më tutje deklaroi se ai i tha Nikollës që t'i fus gjërat në një nga dhomat lartë dhe ai nuk e diti madje se në cilën dhomë Nikolla i futi gjërat. Sidoqoftë, në deklaratën e dhënë Prokurorit Publik me datën 1 dhjetor 2008, Gjini tha se ai kishte vërejtur se Nikolla i kishte futur gjërat në një dhomë në katin e dytë pasi që dera ishte e hapur plotësisht. Kur u pyet nga Gjykatësi Sprenger që të skjaroj, Gjini tha se ai i kishte thënë Nikollës që t'i fus gjërat në një nga dhomat dhe që të merr qelësin me vehte.

Gjin deklaroi se Nikolla nuk ofroi kurrfarë shpërblimi në këmbim të këtij shërbimi. Në këtë pikë, ai u bellafaqua me deklaratën e tij dhënë Prokurorit me 1 Dhjetor 2008, kur ai tha si në vijim: "Nikolla më tha se do të paguante diçka". Kur u kërkua që të jep skjarim për këtë kontradiktë, Gjin deklaroi se Nikolla vetëm e pyeti atë nëse i duhej diçka, por jo në këmbim për shërbimin e dhënë.

Nuk kishte pyetje rreth konfiskimit të pushkës automatike Thompson me numër serial SO7571 dhe për dy granatat e dorës me simbolin A-6Y, pasi që i pandehuri pranoi fajin në këtë pikë.

Gjokë Jakaj ishte marrur në pyetje gjatë shqyrtimit kryesor me 4 gusht 2009.

Gjokë dëshmoi se ai kishte zakon të huazonte veturën nga S. L. kohë pas kohe për nevoja familjare. Herën e fundit, ai e huazoi veturën e S. L. me 16 nëntor, pasi që kishte planifikuar që ta përdorte atë të nesërmen për të shkuar së bashku me motrën që të merrnin pasaportën. Sidoqoftë, ditën e nesërme ai nuk shkoi në Gjakovë, pasi që ishte informuar se pasaporta nuk ishte ende e gatshme.

Me 17 Nëntor, ai shkoi në Gjakovë me Mic Kukelaj për të pi kafe, siç ndodhte shpesh.

Fillimisht Gjokë Jakaj deklaroi se ata arritën në Gjakovë rreth orës 10 apo 11 në mëngjes dhe se gjersa ishin në kafene ata hasën në Nikollë Gojanin: ata vetëm e përshëndetën atë, por Nikolla nuk qëndroi me të. Në këtë pikë i pandehuri u bellafaqua me deklaratën e tij të dhënë 19 dhjetor 2008, ku tha si në vijim:

"Përafërsisht 30 minuta më vonë Nikollë Gojani erdhi aty poashtu dhe ai poashtu piu kafe me ne." Pas bellafaqimit, i pandehuri pranoi se në fakt Nikolla qëndroi me ta për kafe. Mëpastaj, Gjokë u kthye nga Gjakova me Nikollën me veturë, pasi që Micit iu desh që të qëndroj në Gjakovë, por Nikolla nuk e pyeti atë për veturën e S. L.

Gjokë deklaroi se, ditën e njejtë, ai u kthye në Gjakovë përsëri me Micin për të pi kafe. Kur u pyet nga prokurori nëse e kishte takuar Nikollën përsëri, fillimisht i pandehuri u përgjeggj se nuk e kishte takuar dhe përfundimisht, pas ballafaqimit, ai tha se e kishte takuar Nikollën 20 deri 30 minuta para arrestimit të tij.

Gjokë shpjegoi se Nikolla nuk kërkoi nga ai që t'a huazoj veturën por ai kërkoi këtë nga nëna e Gjokës. Pastaj, rreth orës 4 apo 5 pasdite, motra e Gjokës e thirri atë në telefon dhe e informoi se Nikolla kishte huazuar veturën. Pas pyetjes nga Gjykatësi Kryesues, Gjokë shpjegoi se, pasi që ishte në Gjakovë, ai u takua përsëri me Nikollën, dhe e pyeti atë se përse ai kishte marrur veturën dhe përgjigja ishte se ajo i duhej atij.

Gjokë ishte pyetur përse e kishte thirrur në telefon Nikollë Gojanin me 17 nëntor. Ai tha se e kishte thirrur që t'i huazoj nga ai paisjet për rrojë dhe se ai kishte provuar ta merr atë disa herë gjatë mëngjesit por pa sukses. Përfundimisht, ai mundi të merr Nikollën dhe të kërkoj nga ai kompletin e rrojes (që i ishte sjellë atij nga djali i Nikollës). Pasi që matjet e telefonatave treguan se tentimet e mëtutjeshme për arritur Nikollën ishin ndërrmarur nga Gjokë pasdite, i pandehuri ishte kërkuar që të shpjegoj arsyen për këto telefonata dhe u

përgjegj se ai donte të dinte përse Nikolla e kishte huazuar veturën, pasi që motra e tij e kishte informuar atë.

Gjokë poashtu ishte pyetur për mesazhin me tekst në vijim, i dërguar Mic Kukelajt me 17 Nëntor 2007: "Mos merr guxim që të përzihesh në atë biznes. Ku je ti? Dhe nëse don që të vij të marr më thirr. Unë jam duke shkuar në shtëpi". Gjokë shpjegoi se ai kishte menduar se Mic do të rrihej nga ndokush me emrin "V" në lidhje me rrahjen e qenve.

Sa i përket armëve të konfiskuara në shtëpinë e tij (një pushkë automatike Shmajzer me numër serial 168203, dy karikatorë për pushkën e tij, një armë gjuetie me numër serial YU23208, pesë fishekë të kalibrit 7,62x25mm dhe një karkikatorë për revole TT), Gjokë shpjegoi se armët ishin tanimë në shtëpi pasi që ato i takonin babait të tij i cili kishte vdekur gjatë verës së 2008-ës. Ai kishte mësuar nga nëna e tij për ekzistimin e dy armëve një muaj pasi që babai tij kishte vdekur. Pasi që ishte pyetur nga Gjykatësi kryesues se përse nuk i kishte raportuar policisë ekzistimin e këtyre armëve, Gjokë u përgjegj se gjëja e tillë nuk ishte në kulturën Shqiptare.

D. Provat shtesë dhe të dhënat e siguruara gjatë seancave të shqyrtimit kryesor.

Gjykata sipas detyrës zyrtare kërkoi të dhënat penale të të pandehurve nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës dhe Pejës dhe Gjykata Komunale e Gjakovës dhe rezultati ishte se të gjithë të pandehurit më parë nuk kanë qenë të dënuar.

Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarës eksperte ~~A~~ N raporti lidhur me dorëzimin laboratorit të forenzikës të mostrave të substancave të konfiskuara ishte siguruar nga trupi gjykues.

E. VLERËSIMI I PROVAVE TË PREZENTUARA

1. Konstatimet faktike dhe ekzaminimi i pjesëve të provave

Në dritën e provave siç janë mbledhur gjatë hetimeve dhe si janë paraqitur gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, Trupi Gjykues i konsideron se sekuencat në vijim të ngjarjeve si të dëshmuara përtej dyshimit të arsyeshëm.

Me 17 nëntor 2008, Shërbimi Policor i Kosovës, Komanda Regjionale në Pejë, e arrestoi në Gjakovë Mic Kukelajn, i cili po mbante armë pa kurrfarë autorizimi, Nikollë Gojanin dhe Gjokë Jakajn të cilët ishin me të.

Ditën e njejtë , një kontrollë ishte zhvilluar në shtëpinë e Gjokë Jakajt, ku armët dhe municioni në vijim ishte gjetur: një pushkë automatike Shmajzer me numër serial 168203, dy karikatorë për këtë pushkë, një armë gjuetie, me numër serial YU23208, pesë plumba të kalibrit 7,62x25mm dhe një karikator për revolen TT. Një kontroll ishte bërë poashtu edhe në veturën Citroen, me targa 512 KS 951, e parkuar në oborrin e shtëpisë dhe një sasi e vogël e narkotikut u gjet, që më vonë u dëshmuar të ketë qenë e tipit marihuana.

Ditën e nesërme, policia ishin informuar nga Nikollë Gojani se ai kishte magazinuar një sasi të madhe të narkotikëve në shtëpinë e Gjin. Gjokajt dhe andaj ishte kryer një kontrollë në atë shtëpi, ku, në fakt, 152,5 kg të substancës së dyshuar të jetë marihuana ishin gjetur. Në shtëpi ishin gjetur poashtu edhe një pushkë Thompson, me numër serial SO7571, dhe dy granata dore. Gjin Gjokaj andaj ishte arrestuar menjëherë.

Substanca e gjetur ishte ekzaminuar në Laboratorin Kriminal Qendror të PK në Prishtinë të cilët e identifikuan atë si marihuanë (shih ekspertizën e zhvilluar me 30.1.2009).

Nikollë Gojani pranoi, në deklaratën e dhënë me 11.3.2009, përpara Prokurorit (shih deklaratën e mësipërme të konfirmuar nga i pandehuri në shqyrtimin kryesor), se, rreth fillimit të Tetorit, ai ishte pyetur nga një person nga Gjilani (i quajtur D. të cilin ai e njohu përmes një personi tjetër, të quajtur N) që të mbaj substancën për disa ditë në këmbim të 3000 Eurove. Ai e pranoi substancën, të mbështjellur në qese plastike, e cila ishte sjellur në shtëpinë e tij rreth dy javë më vonë dhe e magazinoi atë në shtëpinë e tij.

Edhe pse Nikollë Gojani, në dy deklaratat e tij (me 1.12.2008 dhe me 11.3.2009) pohoi se ai kishte kuptuar se ato ishin narkotikë vetëm pasi që ato ishin sjellur në shtëpinë e tij, nga modaliteti i dorëzimit (njerëz tjerë dhe D. e sollën atë) nga sasia e substancës së dorëzuar dhe nga sasia e parave të premtuara me qëllim që të mbahet substanca, është e qartë se, nga vet fillimi, ai e dinte apo së paku e pranoi mundësinë që substanca të ketë qenë në fakt narkotikë.

Verzioni i dhënë nga Nikollë Gojani është se ai kishte provuar shumë herë të kthej drogën personave të cilët ia kishin dorëzuar atij, por se ata i thanë në mënyrë të përsëritur që të pres; përfundimisht pasi që ai filloi përherë e më shumë të frikësohet nga situata, ai vendosi t'a zhvendos drogën në një vend tjetër dhe kërkoi nga një familjar i largët i tij, Gjin Gjokaj , të mbaj substancën për një apo dy ditë.

Është deklaruar edhe nga Gojani edhe nga Gjokaj (shih deklaratat e Gjokajt të dhëna me 1.12.2008 dhe në shqyrtimin kryesor) se personi i më lartë i tha këtij të fundit qartazi se substanca ishte marihuanë, por, sipas Gjokajt ai nuk e diti kuptimin e asaj fjale, në çfarëdo rasti, ai besoi se ajo ishte ndonjë lloj bari apo bimë mjeksore.

Natyrisht ky pohim nuk është i besueshëm dhe ndeshet në mënyrë të hapur me logjikën e shëndoshë.

Së pari, është e pabesueshme se një person, gati se në të tridhjetat e tij, nuk e din domethënien e fjalës marihuana.

Së dyti, nga modaliteti i dorëzimit (Gjokaj pranoi se Gojani ishte shumë i frikësuar dhe i tensionuar) dhe nga fakti se Gojani premtoi shpërblim për favorin, ishte e pamohueshme se substanca e sjellur në shtëpinë e Gjokajt ishte ilegale (gjatë shqyrtimit kryesor Gjin Gjokaj me kryeneqësi mohoi të ketë pranuar ndonjë premtim për shpërblim, por kur u

bellafaqua me deklaratën e tij të dhënë me 1.12.2008 në të cilën pranoi se Nikollë Gojani i kishte premtuar kompenzim)

Gjin Gjokaj dhe mbrojtësi i tij tentuan të demonstrojnë, përgjatë tërë shqyrtimit kryesor se i pandehuri nuk pati në posedim material drogën, duke theksuar se substanca, edhe pse ishte magazinuar në shtëpinë e Gjokajt, në fakt ishte mbajtur në dhomë me derë të mbyllur (dhe vetëm Gojani i pati qelësat e dhomës). Ky rekonstruim faktik mund të pranohet, sepse nuk ka elemente të kundërt, por në anën tjetër ai nuk e ndërron vlerësimin ligjor: Gjin Gjokaj e lejoi Gojanin të sjell dhe të magazinon drogën në shtëpinë e tij dhe andaj mund të konkludohet se Gjokaj e pati në posedim substancën ilegale.

Është e pakontestueshme se Nikollë Gojani me qëllim që të sjell drogën na shtëpia e tij në shtëpinë e Gjokajt, e përdori një Citroen pick up në pronësi të Sal dhe se, me 16 nëntor 2008, ditën kur droga ishte transportuar: vetura i ishte huazuar Gjokë Jakajt. Është pohuar nga Gojani (shih deklaratën e dhënë me 11.3.2009, faqe 130, dhe konfirmuar nga Jakaj gjatë shqyrtimit kryesor se personi sipërpërmendur kërkoi nga nëna e Jakajt lejen që të merr veturën dhe se ky i fundit nuk ishte në dijeni se kur ishte marrë vetura nga Gojani.

Pas këtyre bazave faktike Prokurori nënkuptoi se që të tre të pandehurit ishin duke vepruar si anëtarë të grupit të përfshirë në një marrëveshje droge dhe kërkoi dënimin e tyre sipas Nenit 229, par.1 i KPPK.

Sa i përket Gojanit dhe Gjokajt është e pamohueshme se ata duhet të fajësohen për drogën e magazinuar dhe të mbajtur në shtëpitë e tyre, por, pas verifikimit të shqyrtimit kryesor, akuza kundër Gojanit dhe Jakajt nuk mund të konfirmohet në tërësinë e saj: në fakt, gjatë rrjedhës së procedurës në tërësi, asnjë provë e vetme nuk është ofruar se të dy të pandehurit vepruan si anëtarë të grupit të përfshirë në marrëveshje droge. Në lidhje me këtë ekzaminimi i mesazheve me tekst lidhur me telefonat e të pandehurve dëshmoi të jetë plotësisht i pavlerë, pasi që nuk ka mesazhe të cilat mund të paku të japin një informatë (shenjë) për pjesëmarrjen e të pandehurve në një grup.

Poashtu ekzaminimi i kontakteve telefonike në mes të të pandehurve ishte i relevancës së pakët, pasi që është e padiskutueshme se të pandehurit e njohën njëri tjetrin dhe andaj është e kuptueshme dhe absolutisht normale që të kontaktojnë njëri tjetrin.

Nga deklaratat e dhënë nga Nikollë Gojani, sigurisht mund të konkludohet ekzistenca e një grupi të njerzve të përfshirë në trafikim me drogë (personi që e kontaktoi Gojanin dhe e dorëzoi drogën), por nuk mund të mbështetet se Gojani personalisht apo Gjokaj ishin anëtarë të këtij grupi. Nga deklaratat e dhëna nga Gojani, paraqitet se ai ishte kontaktuar vetëm nga Doja me qëllim që të mbaj drogën dhe ai nuk diti asgjë tjetër. Në mungesë të çfarëdo pjese të provave që mund t'a kundërshtoj këtë, rekonstruimi i ofruar nga Gojani se ai dëshoi të heq qafe drogën, por ishte i kërcënuar të mos bëj ashtu, duhet të konsiderohet si i besueshëm dhe i vertëtuuar me prova dëshmuese (shih procesverbalin nga 28.7.2009, dëshmia e V.G.

Në anën tjetër, nuk mund të merret, (edhe pse paraqitet të jetë argumentim prapa akuzës së Prokurorit) se sasia e drogës e mbajtur nga të pandehurit është vetvetiu e mjaftueshme të dëshmoj se të pandehurit ishin anëtarë të një grupi.

Në përfundim duhet të theksohet se nuk ka prova se dy të pandehurit ishin duke vepruar si anëtarë të një grupi që merret me drogën e kapur: andaj Nikollë Gojani dhe Gjin Gjokaj duhet të dënohen vetëm për veprën penale të Posedimit të paautorizuar të narkotikëve, në kundërshtim të Nenit 229, para.1 i KPK.

Sa i përket Gjokë Jakajt, fakti i thjeshtë se ai e huazoi veturën nga S.4 me 16 nëntor 2009, se ditën e nesërme Nikollë Gojani huazoi nga nëna e Jakajt veturë njejtë për të dërguar drogën tek shtëpia e Gjokajt dhe se Jakaj, ditën e njejtë, se ishte me Nikollë Gojanin nuk ofron prova të mjaftueshme se Jakaj ishte i përfshirë në marreveshje droge. I pandehuri ka dhënë shpjegim logjik për rrethanat e mësipërme faktike: ai tha se i duhej vetura me qëllim që të nesërmen së bashku me motrënë tij të shkoj në Gjakovë për të marrur pasaportën e saj dhe se ata në fakt nuk shkuan, sepse ai ishte informuar se pasaporta ende nuk është gati. Konsiderimi nga Prokurori se modeli i veturës (Citroen pick up) nuk ishte i përshtatshëm për të transportuar njerëz dhe se andaj ai ishte huazuar për qëllime tjera, jo vetëm që nuk është dëshmuar, por thjeshtë nuk qëndron se modeli pick up i ka së paku dy ulëse dhe andaj mund të përdoret që të transportoj dy njerëz.

Për më tutje vlen të theksohet se mesazhet me tekst në lidhje me mobilin e Jakajt nuk kanë zbuluar asgjë të dobishme për të vërtetuar akuzën lidhur me drogën dhe se disa kontakte telefoni mes Gojanit dhe Jakajt me 17 nëntor 2009 (si në original) janë shpjeguar dhe sqaruar në mënyrë bindëse nga ky i fundit (shih procesverbalin e 4.8.2009).

Sigurisht rrethanat e mësipërme (posaqërisht kontaktet me 17.11.2009 dhe fakti se biseda telefonike ishte shumë e shkurtër, vetëm 8 sekonda, sikurse të ketë patur një marrëveshje tanimë në mes tyre) janë të dyshimta, por një dyshim i thjeshtë, pasi që Prokurori nuk ishte në gjendje të ofroj as një provë të vetme të përfshirjes së të pandehurit në veprën penale, nuk përbëjnë prova.

Sa i përket akuzës së Posedimit të Paautorizuar të Armëve, Gjin Gjokaj pranoi fajësinë: në lidhje me këtë duhet të nënvizohet se, në çfarëdo rasti, se akuza është e fort e bazuar sepse pushka Thomson dhe dy granatat e dorës ishin gjetur në shtëpinë e Gjokajt dhe andaj ishin në mënyrë të pakontestueshme në kontrollin dhe posedimin e tij, megjithatë ai nuk pati kurrfarë leje formale (shih raportin për kontrollin e policisë të kryer në shtëpinë e Gjokajt ditën e arrestimit të tij).

Sa i përket Posedimit të Paautorizuar të Armëve, është e pakontestueshme se Gjokë Jakaj posedoi armët dhe municionin pa kurrfarë autorizimi dhe, andaj, duhet të shpallet fajtor për akuzën. Në këtë pikë, rrethana se armët dhe municioni i takuan babait të tij nuk ka asnjë relevancë, kur mendojmë për faktin se Gjokaj pranoi se ai ishte trashëgimtari i gjërave të babait të tij dhe se ishte informuar për praninë e armëve në shtëpinë e tij vetëm disa muaj pas vdekjes së babait që ndodhi në gusht 2008.

Andaj, është e pamohueshme se, posa që zbuloi praninë e armëve në shtëpinë e tij, ai duhej t'i ketë dorëzuar ato policisë apo së paku të ketë kërkuar lëshimin e kartelës autorizuesë për mbajtje të armës në emër të tij (në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 7/2001). Pasi që ai nuk ndërromori asnjë nga këto veprime, sigurisht mund të konfirmohet se ai në mënyrë të paligjshme posedoi armët dhe municionin të përshtatshëm në aktakuzë.

Lidhur me kualifikimin ligjor të veprave penale, kurrfarë vërejtjesh tjera nuk duhet të bëhen lidhur me aktakuzën përpos, asaj që u përmend më lartë.

2. Propozimet e Palëve

Mbrojtësit e palëve ngritën vërejtje kundër ekspertizës së kryer në substancën e konfiskuar, duke u ankuar për precizitetin e ekspertizës.

Në fakt është e pamohueshme se ekspertiza nuk ishte kryer me saktësi. Në të vërtetë, si e pranoi dëshmitarja eksperte (shih procesverbalin 29.7.2009) ekspertiza e konstatoi vetëm "kualitetin" e substancës së analizuar (duke vlerësuar se ishte cannabis) pa e ekzaminuar "kuantitetin" (psh. Përqindjen e THC të pranishme në substancën e ekzaminuar).

Dëshmitarja eksperte theksoi se në laboratorin e forenzikës në Prishtinë, poashtu si edhe në laboratorët tjerë në Kosovë, nuk ishte e mundur të kryhet ekspertiza lidhur me përqindjen e THC, për shkak të mungesës së rregullave të brendshme procedurale (dhe urgjencave në lidhje me gjykimin dhe faktin se të pandehurit ishin në paraburgim e bënë trupin gjykues që mos t'ia besojnë ndonjë laborator të huaj kryerjen e ekspertizës së re). Rrjedhimisht fakti lidhur me sasinë e madhe të drogës të poseduar humb shumë nga relevanca e vet pasi që fuqia e substancës është e panjohur: natyrisht, kjo e metë kryesore është marrë parasysh nga trupi gjykues kur erdhi tek vendimi mbi dënimin dhe ka qenë vendimtare në qëllimin që të shqiptohet dënimi i largët nga maksimumi i paraparë nga Neni 229, par.1 i KPPK (pesë vjet burgim).

F. KUALIFIKIMI LIGJOR

1. Vlerësimi ligjor i fakteve nga Gjykata

- **Akuza 1. Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike**

Neni 229, par.1 i KPPK, e rradhiti një seri të sjelljeve që duhet të kryhen nga i akuzuari në mënyrë që të dënohet për krimin e lartëpërmendur: në veçanti, ai deklaroi se personi duhet ose të blejë apo posedojë me qëllim të shitjes apo shpërndarjes apo ofrimit për shitje narkotikëve të rrezikshëm apo substanca psikotropike.

Neni 107 i KPPK e definon shprehjen narkotikëve të rrezikshëm dhe substanca psikotropike si substancat e tilla të cekura në Gazetën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë nr. 70/78, 14/81, 39/82, 28/85, 10/87, 53/88, 2/89. Ekspertiza e bërë në narkotikët e gjetur në shtëpinë Gjini Gjokajt sqaroi se substanca ishte *cannabis* (substancë në mënyrë të padiskutueshme të shënuar në listën e mësipërme).

Pas vërtetimit, siç u shpjegua më lartë, se as Gojani e as Gjokaj nuk vepruan si anëtarë të grupit, megjithatë duhet të konfirmohet se të dytë poseduan narkotikët me qëllim që t'i

shesin apo t'i shpërndajn: në fakt, nga sasia e narkotikëve të konfiskuar (152,5kg), është e pamohueshme se narkotikët nuk mundeshin të përdorën për përdorim personal. Prandaj nuk qëndron kurrfarë dyshimi se Gojani dhe Gjokaj e kryen veprën penale të lartpërmendur sa i përket ekzistimit të nevojitur të *actus reus* (posedimi i narkotikëve me qëllim që t'i jepen personave tjerë) dhe të *mens rea* (dashjes për t'a poseduar atë).

- **Akuza 2 dhe 3: Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim e armëve.**

Në nenin 328 par.2 i KPPK, listohen seri të sjelljeve që duhet të kryhen nga i akuzuari në mënyrë që të dënohet për krimin e lartpërmendur: në veçanti neni thotë se personi ose duhet të ketë në pronësi ose të posedoj apo shfrytëzoj armën.

Definicioni i armës është dhënë nga Neni 107, par.28 i KPPK: dispozita i tregon si armë çfarëdo mjeti (përfshirë municionin) të prodhuar që të përdoret ose është i përshtatshëm të përdoret për të shkaktuar lëndime trupore.

Është e pamohueshme se të gjitha mjetet e gjetura dhe të konfiskuara në shtëpitë e Gjokajt dhe Jakajt janë të përfshira në këtë definicion dhe andaj ata kryen veprën penale të lartpërmendur.

Përkitazi me Gjokë Jakajn, ndryshe nga ajo çfarë ai pohoi gjatë marrjes së tij në pyetje, nuk ka prova se për njërin nga pushkët e gjetura në shtëpinë e tij babai i tij e kishte lejen e posedimit.

Andaj kualifikimi i veprës penale të kryer nga i pandehuri është vlerësuar si duhet nga Prokurori si e tillë që bie nën Nenin 328, par.2 dhe jo nën par.4 të nenit të njëjtë.

G. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Kur të shqiptohet një sanksion penal, gjykata duhet të ketë në mend edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit- që është të parandaloj aktivitetet e rrezikshme shoqërore duke i frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjajshme – dhe qëllimin specifik, të parandaloj kryerësin nga kryerja e sërishme e veprave.

Në rastin aktual, trupi gjykues erdhi në përfundim se, posedimi i narkotikëve ishte vepër serioze penale posaqërisht duke menduar sasinë shumë të madhe të substancës së mbajtur nga të pandehurit. Sa i përket rrethanave rënduese, duhet të theksohet sasia e madhe e narkotikëve në posedim të të pandehurve (152,5kg). Sa i përket rrethanave lehtësuese, duhet të merret parasysh se nuk ka dënime të mëhershme kundër të pandehurve, se roli i tyre ishte jashtëzakonisht marginal, se *cannabis* nuk konsiderohet si një nga llojet më të rrezikshme të narkotikëve dhe, si është nënvizuar më lartë, se ekspertiza nuk e sqaroi përqindjen e THC në marihuanën e analizuar (psh. Fuqia e vërtetë e substancës është e panjohur, rrethanë që, në pajtim me parimin *in dubio pro reo*, - Neni 3, par.2 i KPPK- duhet të vlerësohet ashtu si *cannabis-i* i gjetur të mos ketë qenë i kualitetit të mirë dhe për atë arsye edhe jo shumë i fuqishëm).

Për më tutje, lidhur me Nikolla Gojanin, duhet të merret parasysh poashtu bashkëpunimi i dhënë hetuesve (si është shpjeguar nga Prokurori në fjalimin e tij përmbyllës).

Andaj, duke marrur parasysh që të dyja edhe rrethanat rënduese edhe ato lehtësuese, dënimi do të jetë prej 2 vjetëvë burgim dhe një gjobe prej 2.500Euro për Nikollë Gojanin dhe 1 vjet e gjashtë muaj burgim dhe një gjobë prej 2.000Euro për Gjin Gjokajn.

Në lidhje me akuzën Posedimi i Paautorizuar i Armëve, përkitazi me rrethanat rënduese, duhet të vërehet se armët ishin armë të zjarra dhe andaj posaqërisht të rrezikshme; sa i përket rrethanave lehtësuese, duhet të merret parasysh, përsëri se nuk ka dënime të mëhershme kundër të pandehurve (sa i përket Gjin Gjokajt, duhet të merret parasysh se ai e pranoi fajin, por në anën tjetër, dy granatat e dorës janë armë të rrezikshmërisë së veçantë).

Andaj, duke marrur parasysh rrethanat edhe rënduese edhe ato lehtësuese, dënimi do të jetë prej 1 vjet burgim për Gjokë Jakajn dhe 1 vjet e 6 muaj burgim për Gjin Gjokajn.

Sa i përket dënimit unik të Gjin Gjokajt, në saje të rregullave për dënimin e veprave bashkëekzistuese, do të jetë 2 vjet e gjashtë muaj burgim dhe një gjobë nga 2000Euro.

Sa i përket Gjokë Jakajt dënimi do të pezullohet, për shkak të ekzistimit të kushteve të parapara në Nenin 44 të KPPK dhe në saje të shkallës së kufizuar të përgjegjësisë penale të treguar nga i pandehuri.

Koha e kaluar në paraburgim e të pandehurve do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Trupi gjykues lëshoi një vendim të veçantë mbi konfiskimin e artikujve të konfiskuar.

H. SHPENZIMET

Të akuzuarit ishin shpallur fajtor; ata duhet të kompenzojnë shpenzimet e procedurës penale me përjashtim të interpretimit (KPPK, Neni 102, Paragrafi 1). Një vendim i veçantë mbi vlerën e shpenzimeve do të silllet nga gjykata kur shënimet e tilla të sigurohen.

Procesmbajtësi
Robert Abercrombie

Kryetari i Trupit Gjykues
Gianfranco Gallo
[e nënskruar dhe e vulosur]

Mjetet Juridike

Përsonat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut të Pejës/Pec Gjykatës Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë ditëve pas dorëzimit të kopjes së këtij aktgjykimi.

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

